# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2021 – Numri: 173

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 9 nëntor 2021**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 110/2021, datë 8.11.2021 | Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 31, datë 27.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar"...................... | 15513 |
| Dekret i Presidentit nr. 13315, datë 9.11.2021 | Për shpallje ligji.............................................................................................. | 15513 |
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 5.11.2021 | Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave.................................................................................. | 15513 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 3.11.2021 | Për lirim nga detyra.................................................................................... | 15514 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 3.11.2021 | Për emërim në detyrë.................................................................................. | 15514 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 3.11.2021 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.......................... | 15514 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 3.11.2021 | Për një ndryshim në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar .................................................................. | 15516 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 3.11.2021 | Për përdorimin e mjeteve lëvizëse motorike dhe të mjeteve të blinduara për shërbime të veçanta të Gardës së Republikës së Shqipërisë e përcaktimin e ngjyrës dhe të shenjave dalluese të tyre.... | 15537 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 3.11.2021 | Për rishpërndarje të numrit të punonjësve organikë, për vitin 2021, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale........................................................................................ | 15541 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 3.11.2021 | Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2021.................. | 15542 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 3.11.2021 | Për një shtesë në vendimin nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit".................................................. | 15542 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 3.11.2021 | Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Mimoza Ahmeti..... | 15543 |

**LIGJ**
**Nr. 110/2021**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 31, DATË 27.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020, 'PËR BUXHETIN E VITIT 2021', TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 31, datë 27.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar".

Miratuar në datën 8.11.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 13315, datë 9.11.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.**

**DEKRET**
**Nr. 13315, datë 9.11.2021**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 110/2021, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 31, datë 27.10.2021, të Këshillit të Ministrave, 'Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**AKT NORMATIV**
**Nr. 32, datë 5.11.2021**

**PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN E FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT BV* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave e të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
**Miratimi i tekstit të disa ndryshimeve**

Miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2
**Detyrimet e organeve shtetërore**

1. Ndryshimet në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV,* Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, bashkëlidhur këtij akti normativ, për shkak të sekretit tregtar, nuk do të publikohen në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.
2. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike

ndryshimet në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

3. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për tekstin e marrëveshjes, bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 3
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 648, datë 3.11.2021**

**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 649, datë 3.11.2021**

**PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Albana Tole emërohet zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 650, datë 3.11.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për hartimin e ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Ndjek e bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:

i. hartimin e miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;

ii. planifikimin e shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. drejtimin e koordinimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, shtetërore

dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;

iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse, në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019;

b) Kontakton e bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për:

i. prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara;

ii. përgatitjen e propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuar njerëzore;

iv. informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.

3. Nxit, bashkërendon e jep mendim për projektaktet që propozohen nga ministrat, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

4. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në marrëdhëniet e informimit të publikut për çështjet brenda fushës së tij të përgjegjësisë.

5. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për koordinimin dhe drejtimin e punës, ndërmjet ministrive dhe institucioneve, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19.

Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për:

a) koordinimin, drejtimin e ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

b) evidentimin e burimeve financiare të jashtme dhe përcaktimin e mënyrës së përthithjes së tyre, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve përkatëse, për përdorimin e këtyre burimeve;

c) koordinimin e drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

ç) prezantimin e gjendjes dhe të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

d) përgatitjen e propozimin e projekteve, të përgjithshme dhe të veçanta, si pjesë të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

dh) detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

e) koordinimin e drejtimin e punës, si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen e paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

ë) nxitjen, bashkërendimin e dhënien e mendimit për projektaktet që propozohen nga ministritë, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësisë së tij;

f) thirrjen për raportim të strukturave, të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

g) krijimin e drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

gj) bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore, për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive, në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

h) informimin, vazhdimisht dhe në kohë, të Kryeministrit, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19.

6. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për:

a) hartimin e programit të reformave në çdo sektor, sipas fushave përkatëse të institucioneve përgjegjëse, në bashkëpunim me këto të fundit;

b) koordinimin e institucioneve përgjegjëse për hapat që duhet të ndërmerren, me qëllim realizimin e programit të reformave;

c) monitorimin, në mënyrë periodike, të ecurisë së programit të reformave nga institucionet përgjegjëse;

ç) mbikëqyrjen e dhënien e rekomandimeve përkatëse për institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e zbatimit të reformave të ndërmarra apo të atyre në vijim;

d) prezantimin e ecurisë së zbatimit të programit të reformave te Kryeministri, në bashkëpunim me institucionin përgjegjës.

7. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, ka këto kompetenca:

a) merr pjesë në mbledhjet e Komitetit të Emergjencave Civile;

b) thërret për raportim e ngarkon me detyra strukturat e mbrojtjes civile;

c) krijon grupet e punës dhe organizon veprimtarinë për hartimin e miratimin e programeve të procesit të rindërtimit;

ç) bashkërendon me ministritë e institucionet shtetërore, për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit;

d) drejton e koordinon, në nivel qendror, strukturat operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit;

dh) informon vazhdimisht dhe në kohë Kryeministrin, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit e të përdorimit të burimeve materiale e njerëzore;

e) kontakton në vijimësi dhe për çështje të veçanta me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për garantimin e ekspertizës së hartimit e për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

ë) monitoron në mënyrë periodike ecurinë e programit të reformave të institucioneve përgjegjëse;

f) mbikëqyr dhe jep rekomandime për institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e zbatimit të reformave.

8. Vendimi nr. 11, datë 10.1.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin", i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 651, datë 3.11.2021

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 7, të kreut I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2021/448 ..." zëvendësohen me "... i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2021/448 dhe 2021/1470 ...".

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# VENDIME

## VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2021/1470

**10 shtator 2021**

**për ndryshime në Vendimin 2014/145/CFSP për masat kufizuese ndaj veprimeve që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Në mbështetje të Traktatit për Bashkimin Evropian, në veçanti të nenit 29,

Në mbështetje të propozimit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë:

(1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP (1).

(2) Më 12 mars 2021, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2021/448 (2), duke shtyrë edhe 6 muaj masat e vendosura me anë të Vendimit 2014/145/CFSP.

(3) Duke pasur parasysh vazhdimin e dëmtimit ose kërcënimit të integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës, Vendimi 2014/145/CFSP ngelet në fuqi edhe për 6 muajt në vijim.

(4) Këshilli ka shqyrtuar parashikimet individuale të Shtojcës së Vendimit 2014/145/CFSP dhe vendosi të ndryshojë të dhënat e 19 individëve dhe gjashtë organizmave.

(5) Si rrjedhojë, Vendimi 2014/145/CFSP do të ndryshojë përkatësisht,

U MIRATUA KY VENDIM:

### Neni 1

Vendimi 2014/145/CFSP ndryshon si më poshtë vijon:

(1) tek neni 6, paragrafi i dytë zëvendësohet me:

'Ky vendim zbatohet deri më 15 mars 2022.';

(2) Shtojca ndryshohet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.

### Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel 10 shtator 2021.

Për Këshillin
Presidenti
G. DOVŽAN

(1) Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i datës 17 mars 2014 për masat kufizuese ndaj veprimeve që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16).

(2) Vendimi i Këshillit (CFSP)2021/448 i datës 12 mars 2021 për ndryshime në Vendimin 2014/145/CFSP për masat kufizuese ndaj veprimeve që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 87, 15.3.2021, p. 35).

SHTOJCA

Në shtojcën e vendimit 2014/145/CFSP, të dhënat e për individët dhe organizmat e listuara më poshtë zëvendësohen me të dhënat e mëposhtme:

Individë

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| '4. | Denis Valentinovich BEREZOVSKIY<br>(Денис Валентинович БЕРЕЗОВСКИЙ)<br>Denys Valentynovych BEREZOVSKYY<br>(Денис Валентинович БЕРЕЗОВСЬКИЙ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 15.7.1974<br>Vendlindja: Kharkiv, RSS e Ukrainës (tani Ukrainë) | Berezovskiy u emërua komandant i Marinës së Ukrainës më 1 mars 2014, por më pas bëri betimin tek forcat e armatosura të Krimesë, duke thyer kështu betimin e tij për Marinën e Ukrainës.<br>Ai ka qenë Zëvendës Komandant i Flotës së Detit të Zi të Federatës Ruse deri në tetor 2015.<br>Komandant në detyrë i Flotës së Paqësorit të Federatës Ruse dhe Nënadmiral. | 17.3.2014 |
| 17. | Sergei Vladimirovich ZHELEZNYAK<br>(Сергей Владимирович ЖЕЛЕЗНЯК) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 30.7.1970<br>Vendlindja: Shën Petersburg (ish Leningrad), Federata Ruse | Ish nënkryetari i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse. Ai ka mbështetur në mënyrë aktive përdorimin e Forcave të Armatosura Ruse në Ukrainë dhe aneksimi i Krimesë. Ai, personalisht, udhëhoqi demonstratën në mbështetje të përdorimit të Forcave të Armatosura Ruse në Ukrainë.<br>Ish Nënkryetari dhe aktualisht anëtar i Komsionit për Marrëdhëniet me Jashtë të Dumës Shtetërore të Federatës Ruse.<br>Anëtar i Presidiumit të Këshillit të Përgjithshëm të partisë Rusia e Bashkuar. | 17.3.2014 |
| 37. | Sergei Ivanovich MENYAILO<br>(Сергей Иванович МЕНЯЙЛО) | Gjinia: mashkuall<br>Datëlindja: 22.8.1960<br>Vendlindja: Alagir, RSS Autonome e Osetisë së Veriut, BRSS (tani Federata Ruse) | Ish Guvernatori i qytetit të aneksuar të Ukrainës, Sevastopol.<br>Ish Përfaqësuesi Fuqiplotë i Presidentit të Federatës Ruse në Qarkun Federal të Siberisë. Anëtar i Këshillit të Sigurimit të Federatës Ruse.<br>Udhëheqës në detyrë i Osetisë së Veriut që nga 9 prill 2021. | 29.4.2014 |
| 51. | Vladimir Nikolaevich PLIGIN<br>(Владимир Николаевич ПЛИГИН) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 19.5.1960<br>Vendlindja: Ignatovo, Vologodsk Oblast, BRSS (tani Federata Ruse) | Ish anëtar i Dumës Shtetërore dhe ish Kryetar i Komisionit të së Drejtës Kushtetuese të Dumës Shtetërore. Përgjegjës për lehtësimin e miratimit të legjislacionit për aneksimin e Krimesë dhe Sevastopolit nga Federata Ruse. | 12.5.2014 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| | | | Ish anëtar i Këshillit të Lartë të Partisë Rusia e Bashkuar. Këshilltar i Kryetarit të Dumës, Volodin. Aktualisht studiues në Institutin e Shtetit dhe së Drejtës në Akademinë e Shkencave në Rusi.<br><br>Bashkëkryetar i Shoqatës së Juristëve Ruse. | |
| 53. | Oleg Grigorievich KOZYURA<br>(Олег Григорьевич КОЗЮРА)<br>Oleh Hryhorovych KOZYURA<br>(Олег Григорович КОЗЮРА) | Gjinia: mashkull<br><br>Datëlindja: 30.12.1965 ose 19.12.1962<br><br>Datëlindja: Simferopol, Krime ose Zaporizhia, Ukrainë | Ish -drejtor i Zyrës së Shërbimit Federal të Migracionit për Sevastopolin. Përgjegjës për lëshimin e vazhdueshëm dhe të përshpejtuar të pasaportave ruse për banorët e Sevastopolit.<br><br>Ish Shef Kabineti i Kuvendit Legjislativ të Sevastopolit. Këshilltar i Guvernatorit të Sevastopol. | 12.5.2014 |
| 58. | Roman Viktorovich LYAGIN<br>(Роман Викторович ЛЯГИН)<br>Roman Viktorovych LIAHIN<br>(Роман Вікторович ЛЯГІН) | Gjinia: mashkull<br><br>Datëlindja: 30.5.1980<br><br>Datëlindja: Donetsk, Ukrainë | Ish -kreu i Komisionit Qendror Zgjedhor i "Republikës Popullore të Donetskut". Organizoi në mënyrë aktive referendumin më 11 maj 2014 për vetëvendosjen e "Republikës Popullore të Donetskut". Ish "Ministër i Punës dhe Politikave Sociale".<br><br>Subjekt i ndjekjes penale në Ukrainë. | 12.5.2014 |
| 79. | Mikhail Vladimirovich DEGTYARYOV/ DEGTYAREV<br>(Михаил Владимирович ДЕГТЯРЁВ) | Gjinia: mashkull<br><br>Datëlindja: 10.7.1981<br><br>Vendlindja: Kuibyshev (Samara), Russian Federation | Ish -anëtar i Dumës Shtetërore.<br>Si anëtar i Dumës Shtetërore ai shpalli përurimin e "ambasadës de facto" në Moskë të së ashtuquajturës "Republika Popullore e Donetskut" e cila nuk njihet. Ai kontribuon në dëmtimin ose kërcënimin e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës.<br>Ish Kryetar i Komisionit të Dumës Shtetërore Ruse për Edukimin Fizik, Arsimin, Sportin dhe Çështjet e Rinisë.<br>Që nga 20 korriku 2020, Ushtruesi i Detyrës së Guvernatorit të Khabarovsk Krai.<br><br>Që nga 6 shkurt 2021, Koordinator i degës rajonale të Partisë Liberale Demokratike të Rusisë. | 25.7.2014 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| 84. | Fyodor Dmitrievich BEREZIN (Фëдор Дмитриевич БЕРЕЗИН) Fedir Dmytrovych BEREZIN (Федір Дмитрович БЕРЕЗІН) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 7.2.1960<br>Vendlindja: Donetsk, Ukrainë | Ish-i ashtuquajturi "zëvendësministër i mbrojtjes" i të ashtuquajturës "Republika Popullore e Donetskut". Ai është i lidhur me Igor Strelkov/Girkin, i cili është përgjegjës për akte që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Në këtë cilësi dhe me anë të veprimeve, Berezin ka mbështetur aktet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Ai është ende aktiv në mbështetjen e veprimeve apo politikave separatiste. Kryetari aktual i Bordit të Unionit të Shkrimtarëve të RPD dhe Zëvendëskryetar i | 25.7.2014 |
| 108. | Vladimir Abdualiyevich VASILYEV (Владимир Абдуалиевич ВАСИЛЬЕВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 11.8.1949<br>Vendlindja: Klin, Rajoni i Moskës, Federata Ruse | Ish nënkryetar i Dumës Shtetërore. Më 20 mars 2014, ai votoi në favor të projektligjit kushtetues federal "Për pranimin në Federatën Ruse të "Republikës së Krimesë "dhe formimin brenda Federatës Ruse të subjekteve të reja federale -" Republika e Krimesë "dhe Qyteti me Status Federal Sevastopol".<br>Ish -kreu i Republikës së Dagestanit.<br>Që nga 5 tetori 2020, Këshilltar i Presidentit të Federatës Ruse. | 12.9.2014 |
| 111. | Vladimir Stepanovich NIKITIN (Владимир Степанович НИКИТИН) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 5.4.1948<br>Vendlindja: Opochka, Federata Ruse | Ish -anëtar i Dumës Shtetërore dhe ish -Zëvendëskryetar i Parë i Komitetit për Çështjet e KShP[1], Integrimin Euroaziatik dhe Marrëdhëniet me Bashkatdhetarët e Dumës Shtetërore. Më 20 mars 2014 ai votoi në favor të projektligjit kushtetues federal "Për pranimin në Federatën Ruse të "Republikës së Krimesë "dhe formimin brenda Federatës Ruse të subjekteve të reja federale -" Republika e Krimesë "dhe Qyteti me Status Federal Sevastopol ".<br>Anëtar i Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Federatës Ruse.<br>Udhëheqës i lëvizjes publike ruse "Konkordi Rus", i cili përpiqet të krijojë një qytetërim unik rus dhe të forcojë pozicionin e Rusisë në hapësirën ish-sovjetike dhe KShP. | 12.9.2014 |

[1] Komonuelthi i Shteteve të Pavarura

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| 119. | Alexander Mikhailovich BABAKOV (Александр Михайлович БАБАКОВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 8.2.1963<br>Vendlindja: Shisinau, RSS e Moldavisë (tani Republika e Moldavisë) | Ish -anëtar i Dumës Shtetërore. Ish-anëtar i Dumës Shtetërore, Kryetar i Komisionit të Dumës Shtetërore për Dispozitat Ligjore për Zhvillimin e Kompleksit Ushtarak-Industrial të Federatës Ruse. Ai është një anëtar i shquar i "Rusisë së Bashkuar" dhe një biznesmen me investime të mëdha në Ukrainë dhe në Krime.<br>Më 20 Mars 2014, ai votoi në favor të projektligjit kushtetues federal "Për pranimin në Federatën Ruse të" Republikës së Krimesë "dhe formimin brenda Federatës Ruse të subjekteve të reja federale -" Republika e Krimesë "dhe Qyteti i me Status Federal i Sevastopolit".<br>Aktualisht anëtar i Këshillit të Federatës Ruse. Anëtar i Komisionit për Punët e Jashtme.<br>Pas bashkimit të partive politike - "Një Rusi e Drejtë", "Për të vërtetën" dhe "Patriotët e Rusisë", Babakov u bë Sekretar i Presidiumit të Këshillit Qendror të njësisë së bashkuar. | 12.9.2014 |
| 121. | Oleg Konstantinovich AKIMOV (ndryshe i njohur si Oleh AKIMOV) (Олег Константинович АКИМОВ) Oleh Kostiantynovych AKIMOV (Олег Костянтинович АКІМОВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 15.9.1981<br>Vendlindja: Luhansk, Ukrainë | Zëvendës i "Bashkimit Ekonomik të Luhanskut" në "Këshillin Kombëtar" të "Republikës Popullore të Luhanskut". Ai ishte kandidat në të ashtuquajturat "zgjedhje" të 2 nëntorit 2014 për postin e të ashtuquajturit "Krytar" të "Republikës Popullore të Luhanskut". Këto "zgjedhje" ishin në kundërshtim me ligjin ukrainas dhe për këtë arsye ishin të paligjshme. Ish "Kryetar" i të ashtuquajturës "Federata e Sindikatave". Anëtar i të ashtuquajturit "Këshilli Popullor" i "Republikës Popullore të Luhanskut".<br>Duke marrë dhe duke vepruar në këtë cilësi, si dhe më pjesëmarrjen zyrtare si kandidat në "zgjedhjet" e paligjshme, ai ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizuan më tej Ukrainën.<br>Mbështet në mënyrë aktive veprimet ose politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. | 29.11.2014 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| 130. | Ihor Vladymyrovych KOSTENOK (ndryshe i njohur si Igor Vladimirovich KOSTENOK)<br>(Игорь Владимирович КОСТЕНОК) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 15.3.1961<br>Vendlindja: Vodyanske, Dobropillia Rayon, Donetsk oblast, Ukrainë<br>Водянское, Добропольский район Донецкой области, Украина | Ish i ashtuquajturi "Ministër i Arsimit" i "Republikës Popullore të Donetskut".<br>Duke marrë përsipër dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat të cilat dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizuan më tej Ukrainën.<br>Aktualisht punon për Akademinë e Menaxhimit dhe Shërbimit Civil nën të ashtuquajturin "Kryetari i Republikës Popullore të Donetskut".<br>Që nga shtatori 2018, Profesor në Departamentin e Administratës Shtetërore dhe Bashkiake në Institucionin Arsimor Buxhetor të Shtetit Federal të Arsimit të Lartë "Universiteti Ekonomik Rus. G.V. Plekhanov". | 29.11.2014 |
| 131. | Yevgeniy Vyacheslavovich ORLOV (ndryshe Yevhen Vyacheslavovych ORLOV)<br>(Евгений Вячеславович ОРЛОВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 10.5.1980 or 21.10.1983<br>Vendlindja: Snezhnoye, Donetsk oblast, Ukrainë<br>г. Снежное, Донецкой области, Украина | Ish Anëtar i "Këshillit Kombëtar" të të ashtuquajturës "Republika Popullore Donetskut". Ish kryetar i lëvizjes publike "Donbasi i Lirë".<br>Duke marrë përsipër dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizuan më tej Ukrainën.<br>Nënkryetar i Komisionit të Asamblesë Kombëtare të RPD për Industrinë dhe Tregtinë. | 29.11.2014 |
| 137. | Eduard Aleksandrovich BASURIN (Эдуард Александрович БАСУРИН) Eduard Oleksandrovych BASURIN (Едуард Олександрович БАСУРІН) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 27.6.1966<br>Vendlindja: Donetsk, Ukrainë | Zëdhënës shtypi dhe Zëvendës Shefi i "Milicisë Popullore" të së ashtuquajturës "Republika Popullore e Donetskut".<br>Duke marrë përsipër dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizuan më tej Ukrainën.<br>Nënkryetari i "Departamentit të Milicisë Popullore të RPD". | 16.2.2015 |
| 138. | Alexandr Vasilievich SHUBIN (Александр Васильевич ШУБИН) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja 20.5.1972 or 30.5.1972<br>Vendlindja: Luhansk, Ukrainë | Ish i ashtuquajturi "Ministër i Drejtësisë" i të ashtuquajturës "Republika Popullore e Luhanskut". Ish-kryetari i "Komisionit Qendror të Zgjedhjeve" të së ashtuquajturës "Republika Popullore e Luhanskut". | 16.2.2015 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| | | | Duke marrë përsipër dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizuan më tej Ukrainën.<br><br>U shkarkua si kryetar i "Komisionit Qendror të Zgjedhjeve" të të ashtuquajturës "Republika Popullore e Luhanskut" në qershor 2018.<br><br>Regjistruar si noter në Luhansk.<br>Vazhdon të mbështesë dhe legjitimojë politikat separatiste. | |
| 158. | Andrey Vladimirovich CHEREZOV (TSCHERESOW)<br>(Андрей Владимирович ЧЕРЕЗОВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 12.10.1967<br>Vendlindja: Salair, Kemerovskaya Oblast, Federata Ruse | Ish-zëvendësministër për Energjinë i Federatës Ruse.<br><br>Ka edhe ky përgjegjësinë për vendimin për të transferuar turbinat me gaz që ishin dorëzuar nga Siemens Gas Turbine Technologies OOO tek OAO VO Technopromexport, për t'u instaluar në Krime. Ky vendim kontribuon në furnizimin e pavarur me energji të Krimesë dhe Sevastopolit si një instrument për të mbështetur ndarjen e tyre nga Ukraina dhe dëmton integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. | 4.8.2017 |
| 160. | Sergey Anatolevich TOPOR-GILKA<br>(Сергей Анатольевич ТОПОР-ГИЛКА) | Gjinia: mashkull;<br>Datëlindja: 17.2.1970<br>Vendlindja: RSS e Moldavisë (tani Republika e Moldavisë)<br>Shtetësia: Ruse | Në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të OAO "VO TPE", ai udhëhoqi negociatat me Siemens Gas Turbine Technologies OOO në lidhje me blerjen dhe shpërndarjen e turbinave të gazit për një termocentral në Taman, rajoni Krasnodar, Federata Ruse. Ai më vonë, si Drejtor i Përgjithshëm i OOO "VO TPE", ishte përgjegjës për transferimin e turbinave të gazit në Krime dhe për zbatimin e projektit të ndërtimit të termocentraleve Balaklava dhe Tavricheskaya, ku u instaluan turbinat. Kjo kontribuon në furnizimin e pavaruar me energji të Krimesë dhe Sevastopolit si një instrument për të mbështetur ndarjen e tyre nga Ukraina, dhe dëmtonin integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. | 4.8.2017 |
| 164. | Aleksandr Yurevich PETUKHOV<br>Aleksandr Yurievich PETUKHOV<br>(Александр Юрьевич ПЕТУХОВ)<br>Oleksandr Yuriyovych PIETUKHOV<br>(Олександр Юрійович ПЄТУХОВ) | Gjinia: mashkull<br>Datëlindja: 17.7.1970<br>Vendlindja: Ryazan, Federata Ruse | Ish Kryetar i Komisionit të Zgjedhjeve të Sevastopolit. Në këtë cilësi ai mori pjesë në organizimin e zgjedhjeve presidenciale ruse të 18 mars 2018 në Krime dhe Sevastopol të aneksuar në mënyrë të paligjshme dhe | 14.5.2018 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| | | | në këtë mënyrë mbështeti dhe zbatoi në mënyrë aktive politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.<br><br>Inspektori kryesor federal i rajonit të Moskës.<br><br>Që nga 6 prill 2021, Ndihmës i Përfaqësuesit Fuqiplotë i Presidentit të Federatës Ruse në Qarkun Federal Qendror. | |

Organizma

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| '7. | Russian Community "Sobol"<br><br>(Komuniteti Rus "Sobol")<br><br>Русская община "Соболь" | Media sociale:<br>http://vk.com/sobolipress<br>http://www.русскоедвижение.рф/<br>Nr. telefoni:<br>(0652) 60-23-93<br>Email: SoboliPress@gmail.com<br>Adresa: Ukrainë, Krime, Simferopol, Rr. Kiev, 4 (stacioni i autobuzit "Qendër") | Organizata paraushtarake radikale, përgjegjëse për mbështetjen e hapur të përdorimit të forcës për t'i dhënë fund kontrollit të Ukrainës mbi Krime, duke dëmtuar kështu integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.<br><br>Përgjegjës për trajnimin e separatistëve për të luftuar kundër forcave qeveritare të Ukrainës në Ukrainën lindore, duke kërcënuar kështu stabilitetin ose sigurinë e Ukrainës. | 25.7.2014 |
| 11. | "Vostok Brigade"<br>"Бригада Восток"<br>(a.k.a. Vostok Battalion; "Батальон Восток") | Media Sociale:<br>http://vk.com/patriotic_forces_of_donbas<br>http://patriot-donetsk.ru/<br>info.patriot.donbassa@gmail.com | Grupi separatist i armatosur i paligjshëm, i cili konsiderohet të jetë një nga më të rëndësishmit në Ukrainën lindore. Përgjegjës për luftën kundër forcave qeveritare të Ukrainës në Ukrainën lindore, duke kërcënuar kështu stabilitetin ose sigurinë e Ukrainës.<br><br>Mori pjesë aktive në operacionet ushtarake që sollën kapjen e aeroportit të Donetskut.<br><br>Pjesë e të ashtuquajturës "Trupat e Parë të Ushtrisë" të Forcave të Armatosura të "Republikës Popullore të Donestkut". | 25.7.2014 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| 18. | Shoqëria aksionere "Prodhimi-Unioni Agrar" Massandra "<br>Акционерное общество "Производственно-аграрное объединение 'Массандра'"<br>(e njohur më parë si Ndërmarrja e Bashkuar Shtetërore e "Republikës së Krimesë" "Prodhimi-Bashkimi Agrar 'Massandra'"<br>Государственное унитарное предприятие Республики Крым "Производственно-аграрное объединение 'Массандра'"<br>Ndërmarrja Federale Buxhetore e Shtetit "Prodhimi i Bashkimit Agrar" Massandra" e Administratës së Presidentit të Federatës Ruse<br>Федеральное государственное унитарное предприятие "Производственно-аграрное объединение 'Массандра' Управления делами Президента Российской Федерации"<br>"Shoqata Kombëtare e Prodhuesve" Massandra ""<br>Национальное производственно аграрное объединение "Массандра"<br>Nacionalnoye proizvodstvenno agrarnoye obyedinenye "Massandra") | 298650, K r i m , Jaltë, Massandra, Rr. Vinodela Egorova 9.<br>298650, Крым, г. Ялта, пгт. Массандра, ул. Винодела Егорова, д. 9<br>Faqe interneti: http://massandra.su<br>+7 978 936 75 04<br>+7 3654 23 31 96<br>+7 3654 26 16 83<br>Numër regjistrimi: 1209100012648 | Pronësia e subjektit u kalua në kundërshtim me ligjin ukrainas. Më 9 prill 2014, "Presidiumi i Parlamentit të Krimesë" miratoi vendimin Nr. 1991-6/14 "Për ndryshimet në Rezolutën e Këshillit Shtetëror të" Republikës së Krimesë ", të 26 marsit 2014 1836-6/14 "Për shtetëzimin e pronësisë së ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave të kompleksit agro-industrial, të vendosura në territorin e" Republikës së Krimesë " duke deklaruar përvetësimin e pasurive që i përkasin "Shoqatës Kombëtare të Prodhuesve 'Massandra' në emër të "Republikës së Krimesë". Pra ndërmarrja është konfiskuar nga "autoritetet" e Krimesë.<br>Ri-regjistruar më 1 gusht 2014 Ndërmarrja Federale Buxhetore e Shtetit "Proizvodstvenno agrarnoye obyedinenye 'Massandra'" e Administratës së Presidentit të Federatës Ruse (Федеральное государственное унитарное предприятие "Производственно-аграрное объединение 'Массандра' Управления делами Президента Российской Федерации"). Themeluesi: Administrata e Presidentit të Federatës Ruse (Управление делами Президента Российской Федерации).<br>Ri-regjistruar më 1 prill 2019 si Ndërmarrja e Bashkuar Shtetërore e "Republikës së Krimesë" "Prodhimi i Unionit Agrar" Massandra "". Regjistruar më 1 tetor 2020 si shoqëri aksionere "Prodhimi-Unioni Agrar 'Massandra' ". | 25.7.2014 |
| 24. | Lëvizja publike "Republika e Donetskut" Общественное движение "Донецкая республика" | Të dhëna zyrtare:<br>http://oddr.info/<br>orgotdel@oddr.info<br>Adresa: Donetsk, Universitetskaya 19<br>г. Донецк, ул. Университетская, дом 19 | "Organizatë" publike që paraqiti kandidatët në të ashtuquajturat "zgjedhje"<br>e të ashtuquajturës "Republika Popullore e Donetskut" më 2 nëntor 2014 dhe<br>11 Nëntor 2018. Këto "zgjedhje" janë në kundërshtim me ligjin ukrainas dhe për këtë arsye janë të paligjshme. | 29.11.2014 |

| | Emri | Të dhëna identifikimi | Arsyet e përfshirjes në listë | Data |
|---|---|---|---|---|
| | | | Me pjesëmarrjen zyrtare në "zgjedhjet" e paligjshme, ajo ka mbështetur në mënyrë aktive aktet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizojnë më tej Ukrainën. E themeluar nga Andriy PURGIN dhe drejtohej nga Alexander ZAKHARCHENKO. Denis PUSHYLIN i emëruar në 2018 për të qenë "Kreu" i të ashtuquajturës "Republika Popullore e Donetskut". | |
| 28. | Bashkimi Ekonomik i Luhanskut (Luganskiy Ekonomicheskiy Soyuz) Луганский экономический союз | Të dhëna zyrtare: https://vk.com/public97306393 Telegram: https://t.me/s/od_les_lnr | "Organizatë shoqërore" që paraqiti kandidatët në të ashtuquajturat "zgjedhje" e të ashtuquajturës "Republika Popullore e Luhanskut" më 2 nëntor 2014 dhe 11 nëntor 2018. Emëroi një kandidat, Oleg AKIMOV, për të qenë "Kryetari " i të ashtuquajturës "Republika Popullore e Luhanskut" në 2014 dhe anëtar i të ashtuquajturit "Këshilli Popullor i Republikës Popullore të Luhanskut" në 2018. Këto "zgjedhjet" janë në kundërshtim me legjislacionin në Ukrainë dhe për këtë arsye janë të paligjshme. Kryesia e "Luganskiy Economicheskiy Soyuz" aktualisht është e zënë nga Zinaida NADION, e cila është Deputete e "Këshillit Popullor të RPL".<br><br>Duke marrë pjesë zyrtarisht në "zgjedhjet" e paligjshme, kjo organizatë ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet dhe politikat që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe destabilizojnë më tej Ukrainën. | 29.11.2014 |
| 33. | Prizrak brigade Бригада "Призрак" | Adresa: District 50 Year of the USSR, 18; c. of Kirovsk https://vk.com/battalionprizrak http://prizrak.info/ mail@prizrak.info +38 (072) 199-86-39 | Grup separatist i armatosur i cili ka mbështetur në mënyrë aktive veprimet që dëmtojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës si dhe destabilizojnë më tej Ukrainën.<br><br>Pjesë e të ashtuquajturës "Trupat e 2-të të Ushtrisë" të "Republikës Popullore të Luhanskut". Gjithashtu njihen edhe si batalioni i 14 -të i pushkëve automatike.<br>Pjesë e të ashtuquajturës Milicia Popullore e "Republikës Popullore të Luhanskut". | 16.2.2015'. |

L 321/32 EN Official Journal of the European Union 13.9.2021

# DECISIONS

## COUNCIL DECISION (CFSP) 2021/1470
## of 10 September 2021
## amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 17 March 2014, the Council adopted Decision 2014/145/CFSP (1).

(2) On 12 March 2021, the Council adopted Decision (CFSP) 2021/448 (2), thereby renewing the measures provided for in Decision 2014/145/CFSP for a further 6 months.

